

PERMBLEDHJE JO-TEKNIKE

Subjekti: "NUTRIGREEN" SHPK

NIPT: L94530802E

Administrator: Agim Llazi

Adresa: Autostrada Fier-Lushnje, 600m nga kryezimi i Pushimit te Shoferit

TIRANE 2020

Pershkrimi i subjektit

Subjekti "NUTRIGREEN" Sh.p.k kryen aktivitetin "e prodhimit te plehrave kristalore ne ndihme te bujqesise". Subjekti eshte regjistruar ne QKR na date **30.09.2019** dhe eshte themeluar ne date **27.09.2019** ai eshte regjistruar me **Forme Ligjore si Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar Sh.p.k**, i pajisur me nr. Identifikim **NIPT: L94530802E** me Administrator **Z.Agim Llazi**.

Ky subjekt ushtron aktivitetin e tij ne **ne Autostraden Fier-Lushnje, 600 m nga kryqezimi I Pushimit te Shoferit**.




Pershkrimi i skemes teknologjike

Procesi teknologjik kalon ne disa faza. Faza e pare eshte mbushja me material (lenden e pare) ne silloza me Big Bag. Pas mbushjes me material kalon nepermjet shnekeve ne peshore nga e cila del pesha egzakte per secilin produkt sipas recetes se formuluar. Pas peshimit te te gjitha materialeve, perseri nepermjet shnekeve kalon ne mikserin, ku miksimi varet nga produktet, e cila varion nga 5-10 minuta. Pas miksimit

kalon perseri nepermjet shnekut ne linjen paketuese. Pas paketimit te materialit kalon ne paletim, dhe ketu perfundon dhe procesi ku plehu kristalor eshte i gatshem per shitje.

SKEMA TEKNOLOGJIKE E IMPIANTIT

SH- 1:200




LEGJENDE :

- 1- SILLOZA (BIG BAG)
- 2- PESHORE
- 3- MIKSER
- 4- LINJA PAKETIMIT
- 5- PALETIMI

SKEMA TEKNOLOGJIKE E IMPIANTIT



PROJEKTOI	LLAZO shpk
PROJEKTOI	DRITAN KOÇI
KLIJENT	NUTRIGREEN SHPK
	DT. 20.07.2020



- **Lëndët e para dhe ato ndihmëse, substancat e tjera dhe energjia e përdorur ose e gjeneruar nga instalimi;**

Lendet e para që përdoren kryesisht janë plehrat baze që përdoren në bujqësi siç janë Urea, MAP, DAP, Nitrati Amonit, Nitrati Potasit, Nitrati i Magnezit, Nitrati i Kalciumit etj. dhe gjithashtu mikroelementet si hekuri, bori, zinku, manganezi, bakeri, molibdeni etj.

Sasia e lendeve të para merret në varesi të kërkesave të tregut për prodhimin e plehrave kristalore. P.sh neqoftese duam te kryejme nje formulim te nje plehu kristalor 20-20-20+TE (TE=mikroelemente) na duhet te perdorim 20% Ure, 34% MAP, 45% Nitrat dhe 1% TE. Sasia totale e ketyre lendeve te para ne nje dite pune me kapacitet te plote prodhimi eshte 48 ton/dite lende e para e cila nenkupton qe dhe sasia e produktit te perftuar eshte po 48 ton/dite pasi procesi eshte I thjesht ne te cilin behen vetem perzierjet e

ketyre lendeve te para per te perftuar produktin perfundimtare qe eshte pleu kristalore ne ndihme te bujqesise.

Te lendet ndihmese mund te permendim edhe energjiine elektrike e cila do te sherbeje per ndricim te jashtem dhe te brendshem, furnizimi me energji elektrike do te behet komform ligjeve ne fuqi me kontrate te rregullt me OSSHEE.

Uje do te sherbej per sherbimet higjeno sanitare, ujin subjekti do e marri nga nje pus i cili ndodhet ne ambientet e aktivitetit dhe shkarkimet e ujerave te perdorur do te behet ne grope septike.

- **Burimet e shkarkimeve nga instalimi;**

Shkarkimet e ujerave te ndotura dhe mbetjeve te ngurta

Ushtrimi i ketij aktiviteti ne kushte optimale nuk ka ndikim ne nivelin e ujerave tokesore, ne rruget ujore, dhe ne rrjedhen e ujerave nentokesore, pasi nuk ka ndotje te ujit nga, derdhje aksidentale dhe substanca kimike te tjera, pasi ato nuk perdoren ne teknologjine e aplikuar ne kete aktivitet pasi kemi te bejm me aktivitet ushqimor. Persa i perket mbetjeve gjate kryerjes se proceve teknologjike nuk do te kete, mbetjet ne kete aktivitet jane vetem ato qe vijne nga konsumi i perditshem i punonjesve.

Mbetjet urbane (mbetjet shtepiake dhe tregtare, mbetje industriale e institucionale te ngjashme) perfshire fraksionet e mbledhura vecmas.

Keto mbetje percaktohen ne baze te **Vendimit Nr. 99, date 18.02.2005 Per miratimin e Katalogut Shqiptar te Klasifikimit te Mbetjeve.**

Te gjitha keto mbetje te listuara me siper konsiderohen mbetje te parrezikshme pasi nuk kane shkalle te larte ndotjeje ne mjedis dhe nuk kerkojne trajtim te specializuar per asgjesimin e tyre; per mbetjet urbane mjafton qe te depozitohen ne koshat e percaktuara per to nga Pushteti Vendor.

Nje pjese e ketyre mbetjeve te ngurta gjenerohen nga aktiviteti i personelit; ato me KOD 20 Ne baze te Vendimit Nr. 99, date 18.02.2005 Per miratimin e Katalogut Shqiptar te Klasifikimit te Mbetjeve. Sasia e mbetjeve urbane te gjeneruara nga aktiviteti i personelit te punes se ketij aktiviteti eshte **0.0012 ton/muaj**. Sasia totale e gjeneruar e mbetjeve eshte **0.0144 ton/vit**. Do të bëhet menaxhimi i mbetjeve të ngurta, të cilat do të jenë; lëndë të aballazheve, letra- kartona, qelqe, alumin, metale të ndryshme, si dhe lëndë organike të prodhuara nga punonjësit dhe klientet, ku këto mbetje do të transportohen rregullisht në vendin e caktuar nga Pushteti Vendor, ku firma do të marrë masa për menaxhimin e këtyre mbetjeve të ngurta, do të vendosen në kosha selektive sipas rrymave specifike të mbetjeve, ku do të jetë një sasi prej 0.3 kg/dite për person.

Shkarkimet e gazta

Referuar natyres se procesit nga aktiviteti i prodhimit te plehrave kristalore, nuk kemi sasi gazrash te shkarkuara ne atmofer, pasi ne aktivitet ka nje kaldaje e cila pune me energji elektrike dhe ne oxhak do te kete vetem clirimi te avujve te ujit. Gazerat prej mjeteve te punes jane ne intervale kohore te shkurtera, brenda normave te lejuara pa ndonje ndikim negativ ne mjedisin perreth. Gjate ushtrimit te aktivitetit nuk

ka emetime te ndryshme kimike, te cdo lloj qofshin ato. Theksojme se aktiviteti eshte larg zonave te mbedha te banimit dhe shtepive te banimit me te aferta.

Rruget ekzistuese te aksesit apo nevoja per hapje te rrugeve te reja

Per zhvillimin e aktivitetit te subjektit NUTRIGREEN nuk eshte nevoja e hapjes se rrugeve te reja pasi infrastruktura eshte ekzistuese, dhe aktiviteti kryhet ne prone private ne emer te pronarit/administratorit te subjektit.

- Kushtet në vendndodhjen e instalimit dhe rastet e njohura historike të ndotjes;

Kushtet ne vendndodhjen e instalimit jane shume te mira per kryerjen e ketij aktiviteti dhe nuk ka raste te ndotjes ne kete zone. Gjithashtu edhe nga aktiviteti qe do te ushtrohet nuk do te kete ndotje pasi kemi te bejm me nje aktivitet per prodhim plerash kristalore ne ndihme te bujqesise te cilat nuk shkaktojne ndotje.

- Natyra dhe sasi të e shkarkimeve të pritshme nga instalimi në çdo vend/mjedis, si dhe identifikimi i efekteve të rëndësishme të shkarkimeve në mjedis;

- Shkarkimet ne mjedis dhe prodhimi i mbetjeve

Zhvillimi i aktivitetit nuk do te sjell emetime te pluhurave ne mjedis apo burime te tjera ndotese per ajrin, pervec gazeve te cliruara nga automjetet e transportit te cilat jane ne interval te shkurtera dhe brenda normave pasi automjete kolaudohen dhe mirembahen ne menyre te vazhduar. Pajisjet qe do te perdoren per procesin teknologjik dhe transportin e produkteve perfundimtare do te jene bashkohore dhe ne gjendje te mire teknike ne menyre qe te shmangen emetimet nga djegia e lendeve djegese qe ato perdorin.

Karakteristikat e ndikimeve negative ne mjedis

- Metoda e zbatuar per parashikimin e ndikimeve negative ne mjedis

Per vleresimin e ndikimeve ne mjedis te projektit u ndoqen hapat e me poshteme:

- Njohja me projektin dhe teknologjine e tij.
- Njohja me natyren e operacioneve te nevojshme ne mjedis.
- Njohja me vleren natyrore dhe mjedisore te zones dhe vendit ku ndodhet aktiviteti.
- Njohja me infrastrukturen egzistuese dhe nevojten per infrastrukture te re per projektin.
- Njohja me lendet e para qe do te perdoren per zbatimin e projektit.

Duke njohur teknologjine dhe proceset teknologjike u indetifikuan ndikimet e mundeshme negative ne çdo receptore - perberes te mjedisit ne objekt.

Indetifikimi i ndikimeve – Permes te cilit u percaktua nderveprimi mjedis-projekt i prodhimit te plehrave kristalore ne ndihme te bujqesise, Autostrada Fier-Lushnje, 600 m nga kryqezimi I Pushimit te Shoferit, dhe u indetifikuan ndikimet e mundeshme gjate kesaj faze sipas receptoreve te mjedisit.

Vleresimi i ndikimeve – Ekspertet mjedisore te fushave te ndryshme bene perpjekje per matjen e gravitetit te ndikimeve. Vleresimi i Sinjifikances ka te beje me vete rendesine e ndikimeve dhe eshte faza me e rendesishme per zbatuesit e projektit sepse argumenton çdo ndikim negativ dhe peraftron ate me objektivisht me teresine e bashkeveprimeve midis projektit dhe mjedisit. Kriteret e perdorura per vleresimin e rendesise se ndikimeve variojne dhe drejtohen kryesisht nga vlerat e mjedisit te ndikuar.

- Shtrirja fizike dhe kohezgjatja e ndikimeve te identifikuarra (Shkalla)

Shtrirja fizike- Vlereson siperfaqen apo dimesionin hapsinore te nje ndikimi te dhene ne raport me burimin qe gjeneron ate ndikim, p.sh. ndikimi ne ajer nga gazet e mjeteve te transportit i cili eshte i shtrire ne ambientet e jashtme te aktivitetit pa ndikuar ne aktivitetet e tjera qe ndodhen prane.

- **Kohezgjatja e ndikimit** – Vlereson se sa do te zgjase nje ndikim i caktuar ne dimesionin kohe (ndikim i perhershem apo i perkoshem). Ne rastin tone perpunimi i plehrave kristaore eshte nje aktivitet i perhereshem per aq kohe sa do te jete nevoja per keto produkte shume te nevojshme per bujqesine. Ndersa te gjitha ndikimet e tjera negative ne mjedis jane te perkoshme, si shkarkimet ne ajer te gazeve te djegjes nga mjetet e transportit etj.

-**Kthyeshmeria** –Vlereson mundesin e kthimit te mjedisit te ndikuar ne gjendjen e tij te me pareshme (aftesia per tu rehabilituar dhe regjeneruar).

-**Rendesia** – Realizon nje vleresim total te tre permasave te mesiperme dhe njekohesisht thekson vemendjen qe duhet patur per administrimin e ndikimit.

Ndikimet e parashikuara nuk kane shtrirje te madhe fizike, aktiviteti ndodhet ne distance te konsiderueshme nga zona me e afert e banuar dhe nuk preket nga zhvillimi i ketij aktivitetit. Zhurmat qe krijohen gjate proceseve te punes nuk perbejn ndotje akustike sepse jane ne intervale te shkurtera dhe brenda normave te lejuara. Analiza e frekuences se zhurmes te emetuar nga keto makineri dhe pajisje tregon se ato ndodhen nen mesataren e frekuences 100 – 150 Hz, e cila eshte e pranueshme nga veshi i njeriut. Koha ne te cilen do te jene te pranishme keto zhurma eshte vetem gjate dites, meqenese ne aktivitet do punohet vetem me nje turn. Niveli i zhurmave te mjeteve te transportit ne largesi nuk do te jete i madh dhe do te jete konform normave ne fuqi.

- **Teknologjia dhe teknika të tjera të propozuara për parandalimin e shkarkimeve ose, kur kjo nuk është e mundur, për pakësimin e shkarkimeve nga instalimi, veçanërisht duke zbatuar teknikat më të mira të disponueshme;**

Mundesia e zbutjes se ndikimeve dhe argumentimet perkatese nese per ndikime te caktuara nuk mund te zbatohen/ ndermerren masa zbutese

Per te ulur ne minimum ndikimet nga zhurmat do te merren keto masa:

Makinerit e punes, te ngarkimit dhe transportit te produkteve te prodhuara ne kete aktivitet do te jene bashkekohore qe plotesojne standartet shteterore, te pajisura me marmite selenciatore te pakesimit te zhurmave.

Per te ulur me tej ndikimin nga zhurmat puntoret nese do te jete e nevojshme detyrimisht do te perdorin paisjet e mbrojtjes ne pune "kufje".

Brenda zones se aktivitetit vlerat e zhurmave jane gjithmone poshte normave te lejuara. Jane bere matje te nivelit te zhurmave ne disa objekte te ngjashme ku perdoren te njejtat makineri dhe del se ne distancen 10 m nga makinerit zhurmat arrijne nivelin nen 50 dB. Emetimet ne ajer perfaqsohen nga levizjet e automjeteve ne territorin e jashtem teaktivitetit qe bejne transportin e produkteve te prodhuara.

Per mbrojtjen nga gazet e motoreve dizel do te merren keto masa

Mjetet motorrike do te jene bashkekohore qe plotesojne standartet shteterore. Ato do te jene te pajisura me marmita me katalizatore per kapjen e gazeve toksike. Meqenese qendrat e banuara jane ne nje distance relativisht te larget nga zona e aktivitetit ne fjale, keto emetime nuk ndikojne ne to. Gjithashtu nuk do te kete ndikim tek punonjesit e aktivitetit, floren dhe faunen per rreth saj. Per zbutjen e ketyre ndikimeve mbi punonjesit e aktivitetit ata do te jete te ekspozuar pasi punojne ne ambjentet e brendshme.

- Alternativën në lidhje me zgjedhjen e vendit të instalimit dhe teknologjinë e përdorur;

Nuk ka pasur alternative te tjera pervec kesaj alternative qe ne poseidojm per shkak te pronesise se vendit ne emer te pronarit/administratorit duke bere te mundur dhe heqjen e shpenzimeve te qerases pra duke ulur kostot e pronareve per ushrimin e ketij aktiviteti.

- Masat për parandalimin dhe rikuperimin e mbetjeve (nëse është e nevojshme);

Zhvillimi i aktivitetit nuk do te sjell emetime te pluhurave ne mjedis, burime te tjera ndotese per ajrin mund te permendim vetem clirimin e gazeve nga mjetet e transportit dhe pse kjo do te jete ne intervale kohore te shkurtera dhe brenda normave pasi automjetet kontrollohen ne menyre periodike.

Gjate zbatimit te projekteve ne terren duhet te mbahen ne konsiderate mbrojtja e mjedisit dhe standartet mjedisore si dhe te aplikohen masa konkrete. Cdo zbatim projekti duhet te shoqerohet me planin e masave per mbrojtjen e mjedisit dhe shamngien e demeve mjedisore te panevojshme dhe te pariparueshme. Masat per mbrojtjen e mjedisit duhet te planifikohen dhe zbatohen gjate operacioneve me ndikim ne mjedis si ne fazen prergatitore ashtu edhe ate te prodhimit te plehrave kristalore ne ndihme te bujqesise. Ne kete seksion do te trajtohen masat kryesore per mbrojtjen e mjedisit dhe zbutjen e ndikimeve negative te identifikuar ne seksionin paraardhes. Masat e propozuara lidhen me fazat dhe aktivitetin ne fjale si me poshte:

Masat për zbutjen e ndikimeve negative në mjedis gjatë fazës së kryerjes së proceseve të punës së aktivitetit për punimin e plehrave kristalore në ndihmë të bujqësisë dhe Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative:

- Evadimi i mbetjeve urbane sipas legjislacionit në fuqi.
- Te kryej auditim të vazhdueshëm të energjisë me ekspert të licensuar.
- Te mirembaje në mënyrë të vazhdueshme linjen teknologjike të prodhimit të plehrave kristalore.
- Te kete vëmendjen maksimale ndaj kushteve higjieno-sanitare.
- Te kryej inspektime të përditshme për kushtet higjieno-sanitare dhe për kushtet e punës së punonjësve.

- **Masat për përdorimin eficient të energjisë:**

Subjekti në fjalë do të furnizohet me energji elektrike nga rrjeti. Makinerite dhe mjetet e procesit teknologjik funksionojnë me energji elektrike, ndërsa mjetet e transportit përdorin lëndë djegëse të lenget gasoil. Thëksojmë se përdorimi i këtyre burimeve nuk ka ndikim në zonë, sepse sigurohen sipas procedurave dhe nga subjekte të licensuara.

- **Masa të tjera të planifikuara në përputhje me parimet e përgjithshme që rregullojnë detyrimet themelore të operatorit, dmth:**

- a) janë marrë masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre;
- b) janë ndërmarrë masat e nevojshme, me ndërprerjet definitive të aktiviteteve, për të shmangur ndonjë rrezik të ndotjes dhe kthimin e vendit të operimit në gjendje të kënaqshme;

Rreziqe me pasojë në mjedis

Renien e ndonjë zjarri në ambientin e brendshëm të aktivitetit.

Rreziqet me pasojë në mjedisin human dhe ekonomik

- Aksidentet e punonjësve gjatë procesit teknologjik në aktivitet.
- Aksidentet si pasojë e rënies së zjarrit.

Probabiliteti i ndodhjes për secilin nga rastet e mësipërme do të varet shumë nga masat mbrojtëse që do të parashikohen dhe zbatohen. Zhvillimi i aktivitetit nuk shoqërohet me aksidente të cilat mund të sjellin pasojë të demshme në mjedis si ndotje të ujërave nga lëndë të rrezikshme, emetime në ajër nga gaze helmuese etj.

- **Monitorimi i planifikuar i shkarkimeve nga instalimi.**

Subjekti do te monitoroje aktivitetin e e perpunimit te plehrave kristalore ne ndihme te bujqesise ne disa drejtime sipas nje programi te hartuar per kete qellim. Ne pergatitjen e programit te monitorimit mjedisor merret ne konsiderate mundesia e realizimit te nje monitorimi te elementeve me ndikim ne mjedis. Vetemonitorimi aktivitetit nga subjekti do te behet per ata elemente qe parashikohet se kane ndikim negativ ne mjedis. Te dhenat e marra nga monitorimi do te evidentohen ne regjistrin perkates dhe me rezultatet e matjeve do te informohen organet e administrimit te mjedisit ne qender dhe ne qark. Te dhenat cilesore, sipas tabelës do te hidhen ne nje regjister qe administrohet nga vete kompania dhe do te dorezohen ne AKM dhe DRM sa here eshte e nevojshme, sipas procedurave ligjore dhe rregulloreve.

Me **VKM per programin e monitorimit ne RSH** jepen qarte indikatorët mjedisor qe monitorohen, megjithate keta indikator duhet te pershaten dhe ti perkasin veprimtarise. Qellimi i monitorimit mjedisor per veprimtarine e projektit te zbatuar eshte qe te siguroje te dhena nepermjet te cilave te vleresohet nese operimi i veprimtarise eshte ne perputhje me ligjet dhe standartet mjedisore qe lidhen me te, si dhe per te vleresuar performancën mjedisore te menaxhimit te saj ne kuader te permiresimit te vazhdueshem.

Nr	Elementi i monitorimit	Frekuenca
1	Monitorim i zhurmave te mjeteve transportit	Vazhdimisht
2	Monitorimi i gjendjes se paisjeve e makinerive,	Vazhdimisht
3	Monitorim i faktoreve qe shkatojne fatkeqesi natyrore dhe humane.	Vazhdimisht
4	Monitorim i i paisjeve te procesit teknologjik perpunimin e plehrave kristalore ne ndihme te bujqesise	Vazhdimisht

Indikatorët e mesiperme te monitorimit jane nje nderthurje treguesish me te cilet vleresohet trysnia qe ushtron zbatimi i ketij projekti ne mjedis si dhe gjendja e mjedisit, ndikimit e funksionimit te projektit te zbatuar ne kete objekt. Matja dhe mbledhja e te dhenave per treguesit e mesiperme do te behet konform metodave dhe teknikave shkencore te njohura dhe te pranueshme. Te dhenat qe do te mblidhen do te vihen ne dispozicion te organeve shteterore dhe te interesuarve te tjere, gjithashtu keto te dhena do te analizohen me qellim permiresimin e performances mjedisore te veprimtarise dhe berjen e korigjimeve te nevojshme. Per te ruajtur te dhenat mjedisore te veprimtarise do te pergatitet dhe mbahet nje regjister i veçant ku do te hidhen vazhdimisht te dhenat mjedisore.